

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS**, në mbështetje të nenit 19 të Statutit të OFK-së nr. 134, datë 04.06.2025, nenit 9, paragrafëve 1, 2, 4 dhe 13, si dhe nenit 31 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së, nr. 275, datë 30.12.2024, në mbledhjen e mbajtur më 30.04.2026, nxjerr këtë:

**Oda e Farmacistëve të Kosovës**  
**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

Nr. 24      Datë 30/04/26

## VENDIM

**I. Hapet gara zgjedhore për kandidim për anëtarë të Kuvendit të OFK-së për legjislaturën e katërt, në afatin nga data **04.05.2026 deri më 14.05.2026**.**

**II. Kandidati për anëtar të Kuvendit të OFK-së duhet të plotësojë këto kushte:**

1. Të jetë në listën votuese të certifikuar nga KQZ në njësinë ku kandidon;
2. Të ketë mbështetjen e së paku pesë (5) anëtarëve të njësisë përkatëse;
  - o Një anëtar/e mund të mbështesë vetëm një (1) kandidat/e për Kuvend;
  - o Kandidati/ja nuk mund ta nënshkruajë mbështetjen për kandidaturën e tij/saj;
3. Të mos jetë i/e dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale që lidhen me keqpërdorimin e detyrës zyrtare apo kundër shëndetit publik;
4. Të mos i jetë shqiptuar masa e tërheqjes së licencës për tre (3) apo më shumë vite gjatë pesë (5) viteve të fundit;
5. Të mos jetë anëtar/e i/e KQZ-së apo KNJZ-së.

**III. Dokumentet e nevojshme për kandidim janë:**

1. Formulari i plotësuar i kandidimit, i cili merret në ueb-faqen zyrtare të OFK-së;
2. Certifikata mbi dënimet penale, e lëshuar përmes platformës e-Kosova;
3. Vërtetimi etik nuk kërkohet, pasi KQZ është njoftuar zyrtarisht se nuk ka masa të tilla të shqiptuara.

**IV. Kandidaturat dorëzohen fizikisht në zyrat e OFK-së, nga data **04 maj deri më 14 maj 2026**, në orarin **08:30 – 15:00**.**

**V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

I dërgohet:

- Anëtarëve të OFK-së;
- Sekretariatit të KQZ-së.

**Kryetari i KQZ-së**  
Mr.Ph. Betim Ramadani

*B. Ramadani*

**Oda e Farmacistëve të Kosovës**  
**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**  
Façe 1 nga 1  
**OFK - KQZ**